



**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

**RREGULLORE
PËR PROCEDURAT DHE PARIMET MINIMALE NË LIDHJE ME SISTEMIN E
KONTROLLIT TE BRENDSHËM DHE ASPEKTE TË TJERA TË SISTEMIT TË
INFORMIMIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT**

Miratuar me vendim Bordi nr. 135, datë 31.10.2014

**Neni 1
Objekti**

Objekt i kësaj rregullore është përcaktimi i procedurave dhe parimeve minimale lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe aspekte të tjera të sistemit të informimit të shoqërive së sigurimit që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 2
Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në bazë të nenit 121, pika 8, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

**Neni 3
Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore zbatohet për të gjitha shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të ushtruar veprimtari sigurimi dhe risigurimi në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 4
Përkufizime**

1. Në zbatim dhe për efekt të kësaj rregulloreje termat e përdorur kanë të njëjtin kuptim me ato, të përcaktuar në nenin 4, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe në aktet rregullative të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1, të këtij neni, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Sistemi i kontrollit të brendshëm” - janë rregullat dhe parimet e krijuar nga shoqëria për monitorimin dhe zbatimin e politikave e të procedurave të brendshme, për vlerësimin e efektivitetit të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit si dhe për monitorimin e ushtrimit të veprimtarisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- b) “Ligji i sigurimit” - është Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
- c) “Shoqëria” - është shoqëria e sigurimit dhe risigurimit në kuptimin e ligjit të sigurimeve;
- d) “Sistemet TIK” - janë sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Neni 5

Sistemi i kontrollit të brendshëm

Sistemi i kontrollit të brendshëm përfshin:

- 1. Tërësinë e rregullave dhe parimeve të monitorimit dhe të vlerësimit të mjaftueshmërisë dhe efektivitetit të politikave, të procedurave dhe mekanizmave të kontrollit brenda një shoqërie sigurimi dhe të cilësisë së operacioneve të veprimtarisë së saj të kryera nga strukturat e administrimit, drejtimit dhe kontrollit të saj, si dhe nga personat që kryejnë funksionet e kontrollit të brendshëm.
- 2. Bashkërendimin e veprimtarisë së strukturave, të mekanizmave dhe procedurave të kontrollit që duhet të sigurojnë:
 - a) monitorimin e zbatimit të politikave të shoqërisë, duke vlerësuar shkallën e realizimit të objektivave të shprehur në këto politika;
 - b) përdorimin efektiv të burimeve;
 - c) identifikimin, matjen dhe monitorimin e nivelit të rreziqeve si dhe parandalimin dhe administrimin efektiv të tyre;
 - d) ruajtjen e aktiveve;
 - e) informacion të përshtatshëm, të saktë dhe të besueshëm të gjendjes financiare të shoqërisë dhe administrimin e tij sipas procedurave të shoqërisë;
 - f) përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe zbatimin e politikave, të rregullave dhe procedurave të brendshme, të miratuara nga këshilli i administrimit ose drejtoria;
 - g) rishikimin e vazhdueshëm të kësaj strukture, procedurave, proceseve dhe mekanizmave me qëllim përshtatjen e tyre me kushtet e reja të veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 6

Parimet për ndërtimin e strukturës së Kontrollit të Brendshëm

1. Shoqëria siguron kryerjen me efektivitet të kontrollit të brendshëm në mënyrë të mjaftueshme dhe të pavarur nga këshilli i administrimit ose administratori/anëtari i bordit të drejtorëve të shoqërisë.
2. Organizimi i sistemit të kontrollit të brendshëm të shoqërisë dhe miratimi i rregullave mbi mënyrën e ushtrimit të funksionit të kontrollit të brendshëm nga këshilli i administrimit/mbikëqyrës i shoqërisë, duhet të bëhet në përputhje me:
 - a) madhësinë dhe specifikat e aktivitetit të shoqërisë;
 - b) llojet e mbulimeve të ofruara dhe nivelin e rreziqeve;
 - c) nivelin dhe qëllimin e kontrollit të ushtruar;
 - d) përshtatshmërinë dhe saktësinë e regjistrimeve kontabël dhe të regjistrimeve të tjera.

Neni 7

Strukturat e sistemit të kontrollit të brendshëm

1. Strukturat kryesore përgjegjëse për realizimin e funksionit të kontrollit të brendshëm janë:
 - a) asambleja e përgjithshme;
 - b) këshilli i administrimit (në sistemin me një nivel) ose këshilli mbikëqyrës dhe administratori/ bordi i drejtorëve (në sistemin me dy nivele);
 - c) komiteti i auditimit;
 - d) drejtoria dhe çdo strukturë tjetër drejtuese me karakter ekzekutiv në shoqëri;
 - e) njësia e kontrollit të brendshëm;
 - f) komitetet e veçanta, të ngritura me vendim të këshillit të administrimit/këshilli mbikëqyrës dhe administratori/bordi drejtorëve për trajtimin e çështjeve që kanë lidhje me kontrollin e brendshëm të shoqërisë.
2. Strukturat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni janë përgjegjëse për realizimin e funksionit të kontrollit të brendshëm, në përputhje me detyrat dhe kompetencat e përcaktuara në:
 - a) ligjin e sigurimit dhe/ose aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij;
 - b) këtë rregullore;
 - c) statutin e shoqërisë; si dhe

- d) rregullat e miratuara nga këshilli i administrimit, mbi mënyrën e ushtrimit të funksioneve të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Neni 8

Elementet e sistemit të kontrollit

Sistemi i kontrollit të brendshëm të shoqërisë përbëhet nga:

- a) procedurat dhe rregullat përkatëse;
- b) funksioni i auditimit të brendshëm;
- c) kontrolli i administrimit të rrezikut; si dhe
- d) sisteme të informimit të shoqërisë.

Neni 9

Procedurat dhe rregullat e brendshme

1. Këshilli i administrimit/mbikëqyrës dhe administratori/bordi i drejtorëve, në kuadër të administrimit të shoqërisë përveç përgjegjësi kryesore të përcaktuara në nenin 22, të ligjit të sigurimit miraton dhe rishikon periodikisht:

- a) strukturën organizative, të administrimit dhe të funksionimit të shoqërisë, sidomos të strukturave përgjegjëse për realizimin e funksionit të kontrollit të brendshëm, marrëdhëniet raportuese dhe kontrolluese brenda saj;
- b) rregullat dhe procedurat për përcaktimin e kufijve të kompetencave, delegimin e tyre dhe ndarjen e përgjegjësi për administratorët dhe punonjësit e shoqërisë;
- c) kompetencat për autorizimin, ndjekjen dhe raportimin e operacioneve të shoqërisë;
- d) rregullat dhe procedurat e brendshme për monitorimin e rreziqeve dhe vlerësimin e efektivitetit të procedurave dhe metodave për administrimin e tyre;
- e) mënyrën e raportimit të mangësive (pamjaftueshmëri), të identifikuar në sistemin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë;
- f) kodin e etikës dhe parimet e trajtimit të konflikteve të interesit për anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorin/anëtarin e bordit të drejtorive dhe funksionarët kryesorë të shoqërisë;
- g) rregullat mbi papajtueshmërinë dhe ndalimet në ushtrimin njëkohësisht të më shumë se një funksioni në lidhje me autorizimin, kryerjen dhe raportimin e operacioneve të shoqërisë;
- h) kompetenca të tjera, që i shërbejnë përmirësimit të funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Neni 10

Funksioni i Auditimit të brendshëm

Funksioni i auditimit të brendshëm, si pjesë e strukturës së sistemit të kontrollit të brendshëm, është objekt i rregullores për ushtrimin e funksionit të auditimit të brendshëm në shoqërinë e sigurimit, miratuar nga Autoriteti.

Neni 11

Kontrolli i administrimit të rrezikut

Kontrolli i administrimit të rrezikut si pjesë e strukturës së sistemit të kontrollit të brendshëm, është objekt i rregullores për organizimin dhe funksionimin e sistemit të administrimit të rrezikut të shoqërisë, miratuar nga Autoriteti.

Neni 12

Sistemet e informimit të shoqërisë

1. Shoqëria harton dhe zbaton procedura të përshtatshme raportimi dhe komunikimi, të cilat krijojnë mundësi për përdorimin e informacionit sipas të drejtave të punonjësve të shoqërisë, si dhe për lëvizjen e informacionit sipas linjave të mëposhtme:
 - a) nga poshtë - lart, në mënyrë që organet drejtuese të jenë në dijeni për operacionet, rreziqet dhe ecurinë e veprimtarisë aktuale të shoqërisë;
 - b) nga lart - poshtë, për informimin e personelit rreth strategjive dhe objektivave të shoqërisë si dhe rreth politikës, rregullave dhe vendimeve të miratuara nga organet drejtuese, të cilat ndikojnë në detyrat dhe përgjegjësitë e tyre; si dhe
 - c) në mënyrë horizontale, për të siguruar që informacioni është shpërndarë siç duhet ndërmjet strukturave të saj.
2. Shoqëria regjistron në sistemet e saj të brendshme, të gjitha transaksionet dhe operacionet në kohën e duhur, në mënyrë të plotë dhe në rend kronologjik, sipas procedurave të përcaktuara në aktet e saj të brendshme.
3. Shoqëria dokumenton të gjitha transaksionet në dosje (file) dhe/ose në çdo dokument tjetër në formë elektronike, të klasifikuara sipas llojit të operacionit, klientit dhe kriterëve të tjera të zgjedhura prej tyre. Dosjet e dokumenteve të shoqërisë përmbajnë:
 - a) inventarin e dokumenteve në përbërje të dosjes;
 - b) dokumentet e brendshme të shoqërisë, informacione, marrëveshje, kontrata etj;
 - c) informacionin financiar dhe çdo informacion tjetër për klientelën dhe tregun;

- d) informacione të një rëndësie të veçantë për shoqërinë; si edhe
- e) dokumente të tjera.

Neni 13

Mbrojtja e informacionit në sistemet TIK

1. Organet drejtuese të shoqërisë, me qëllim mbrojtjen e informacionit në përdorimin e sistemeve TIK, miratojnë procedura dhe përcaktojnë përgjegjësitë dhe detyrat që lidhen me:
 - a) zhvillimin, zbatimin dhe modifikimin e sistemeve TIK;
 - b) mirëmbajtjen e sistemeve TIK;
 - c) administrimin e sistemeve TIK; dhe
 - d) përdorimin e mbrojtjen e informacionit elektronik.
2. Sistemet TIK të shoqërisë sigurojnë:
 - a) mundësitë e duhura për përdorim të kufizuar të informacionit, në përputhje me funksionin dhe përgjegjësitë e personelit sipas vendit/pozicionit të punës;
 - b) procedura për kryerjen e kontrolleve të mjaftueshme, përfshirë punën e njësisë së kontrollit të brendshëm dhe të shoqërisë audituese të miratuar.
3. Këshilli i administrimit miraton politika të brendshme të përdorimit të sistemeve TIK, të cilat synojnë të parandalojnë dhe kufizojnë:
 - a) gabimet në fazat e modifikimit dhe zhvillimit të programeve (software), të administrimit të sistemit dhe përdorimit të të dhënave elektronike (database);
 - b) ndërprerjen e operacioneve për shkak të faktorëve të rastit, të brendshëm apo të jashtëm;
 - c) mashtrimet dhe mundësitë e përdorimit abuziv të informacionit.
4. Shoqëria rishikon vazhdimisht procedurat dhe politikat e brendshme për përdorimin e sistemeve TIK, në përshtatje me llojet e rreziqeve.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI